



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPIJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primitjeno: 18.03 2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-12189		



KOMUNA E LIPIJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 16.12.2024, Drejtori/ja DKRS –së merr këtë :

VENDIM PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE PËR OJQ

I

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të Organizatave Joqeveritare në fushën e Kulturës dhe Sportit për organizimin e Festivalit të Këngës për fëmijë “Lipjani Këndon 2025”

II

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti I KOMUNËS (DKRS) kodi ekonomik 85003 SUBVENCIONE në kuadër të Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III

1. Mjetet e përmendura në nenin II do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike ;
2. Udhëzimet për aplikantët ;
3. Formularët e aplikimit ;

4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve ;

5. Format për raportimin e zbatimit të projektit ;

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit ;

2. Forma e buxhetit të programit apo projektit ;

3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta ;

4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme) ;

5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike ;

6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit ;

2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin ;

3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit ;

V

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe).

VI

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Lipjan 18.03.2025

Anila Reçica Llugiqi

Drejtoreshë e DKRS-së

